



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

ARJ.nr.180/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit ASH “G.” me seli në P., Rr. “S.”, nr....., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1049/22 të datës 20.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24 Janar 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, (ATK), me seli në Prishtinë, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1049/22 të datës 20.03.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1049/22 të datës 20.03.2023, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 13.11.2020, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1215/18, të datës 08.12.2020, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1049/22 të datës 20.03.2023, e paditura në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa e të paditurës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të priset, ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1049/22 të datës 20.03.2023, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1215/18 të datës 08.12.2020, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës – ATK nr.436/2009 datë 08.12.2009 ose të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomës së shkallës së dytë dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje

Administrative, Divizioni Fiskal dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala paditëse.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjyqimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditurës dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës - Departamenti i Ankesave, me nr.436/2009 të datës 08.12.2009, në pikën I. të dispozitivit të vendimit është refuzuar ankesa e tatimpaguesit ASH "G.", me, pronar: Xh. A. nga P., Rr: "S.", si e pa bazë kundër vendimit mbi Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të Administratës Tatimore – Regjioni Prishtina II. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të vendimit, theksohet se procedura e ankesës nuk ndërprente sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.1215/18 të datës 08.12.2020, në dispozitiv të tij ka vendosur si në vijim: në pikën I. APROVOHET kërkesëpadija e paditësit ASH "G." me seli në P., Rr. "S.", nr.... Në pikën II. ANULOHET vendimi me nr.436/2009 i datës 08.12.2009 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në P...., që paditësin ASH "G." me seli në P., Rr. "S.", nr....., ta liroj nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë për të gjitha llojet e tatimit shtesë mbi bazat e aplikimit të çmimit të rritur për shërbimet e kontrollit teknik të automjeteve sipas njoftim Rivlerësimeve të Administratës Tatimore të Kosovës – Regjioni P..... II, të datës 28.09.2009, të përpiluara sipas raportit të Kontrollit të datës 24.09.2009. Në pikën III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga Raporti i Kontrollit i ATK-së i datës 28.09.2009, gjykata konstaton se e paditura ATK-Regjioni P... 2, ka kryer vlerësim tatimor (kontroll tatimore) për paditësin për periudhat dhe llojet e tatimeve Tatim në të Ardhura Personale (TAP-IS)TM1/07-TM4/07, Tatim Mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për periudhën 05/2008-12/2008, Tatim të Mbajtur në Burim (TMB) për periudhën 09/07-12/2008, dhe për Kontribute Pensionale (KP) për periudhën 09/07-12/2008. Me raport të kontrollit paditësi është ngarkuar me qarkullim shtesë për vitin 2007 në vlerë prej 13,883.00€, dhe për vitin 2008 në vlerë prej 56,990.20€, apo në shumë të përgjithshme prej 70,873.20€, për të dy vitet, për Tatim në të Ardhura Individuale. Deri tek ky qarkullim shtesë me kontroll është ardhur si rezultat i asaj që kontrolli ka kontestuar çmimet e aplikuar nga paditësi për kontrollim teknik të automjeteve me peshë deri në 3.5 ton, të cilat kanë qenë 10€ dhe 15€ për automjet, duke aplikuar çmimin me kontroll prej 25€ për çdo automjet i cili e ka kryer kontrollin teknik tek paditësi, krejt kjo bazuar në çmimoren e Ministrisë së

Transportit dhe Post-Telekomunikacionit të nxjerr me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. reference MTPT 332/09 i datës 06.07.2009.

Tutje theksohet se: Gjykata konstaton se në vendimin e kontestuar të Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr.436/2009 i datës 08.12.2009, por edhe në Raportin e Kontrollit i datës 28.09.2009, nuk është vërtetuar për ndonjë parregullsi ligjore nga ana e paditësit, në kuptimin se nuk lëshohen faturat e shitjes apo kuponët e shitjes klientëve, ose që kuponët e lëshuar në emër të shërbimeve të kryera për kontrollimin teknik të automjeteve, nuk regjistrohen në librin e shitjes, për të provuar nën deklarinimin e qarkullimit të biznesit të paditësit, të pretenduar nga e paditura.

Gjykata e vlerëson të pa bazuar arsyetimin e të paditurës të dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit *“kontrolli pas krahasimit të tatimpaguesit me shkresat e lëndës nga MTPT, nga MPB-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë si dhe legjislacionin në bazë të Cilit operon tatimpaguesi, ka konstatuar se tatimpaguesi ka nën dekluarar shitjet e tij”*, sepse me asnjë provë e cila gjendet në shkresat e lëndës qoftë nga MTPT, MPB-Policia, apo institucion tjetër nuk është dëshmuar për nën deklarinim të qarkullimit nga ana e paditësit. Gjykata vëren se në shkresat e lëndës nga MTPT ekziston evidenca mbi numrin e kontrollimeve teknike të kryera ndër tjera edhe nga paditësi gjatë vitit 2008, që përputhet me të dhënat e deklaruara nga paditësi për vitin 2008, ku edhe me raport të kontrollit është konstatuar se në vitin 2008 paditësi ka realizuar 4.493 kontrollime teknike, ndërsa në vitin 2007, ka realizuar gjithsej 945 kontrollime teknike, dhe se deri tek tatimi shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së çmimit të deklaruar nga paditësit për kontroll telefonik, nga çmimi i deklaruar nga paditësi prej 10- 15€ për kontrollim teknik për automjete, në çmimin prej 25€ të vlerësuar nga e paditura, bazuar në vendimin mbi përcaktimin e çmimit të kontrollës teknike për mjetet motorike të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të nënshkruar me datë 20.07.2009, sipas të cilit vendim ishte përcaktuar çmimorja për shërbimet e kontrollimit teknik të automjeteve.

Gjykata konstaton se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore aplikimi i çmimores të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës e datës 20.07.2009, siç ka vepruar e paditura në këtë rast, për arsye se, siç shihet nga Ligji nr.02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, ku është bazuar ky vendim për përcaktim të çmimeve për shërbimin e kontrollit teknik të automjeteve, tek neni 376 i këtij ligji për paraparë se *“Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm”*. Në këtë drejtim gjykata konstaton se shpallja e këtij ligji nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është bërë me rregulloren e UNMK/REG/2007/33 të datës 12.12.2007, dhe se kjo datë konsiderohet edhe si datë e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa nga ana tjetër në vendimin mbi përcaktimin e çmimores për shërbimet e kontrollit teknik të automjeteve në nenin 10 të tij, thuhet shprehimisht që *“ky vendim hyn në fuqi me datë 20.07.2009”*. Në kontekst të këtij argumenti, gjykata konstaton se e paditura pa të drejtë dhe në kundërshtim me ligjin, bazuar në këtë vendim e ka ngarkuar paditësin me qarkullim dhe tatim shtesë, duke ja rritur çmimet e deklaruar për shërbimet e kontrollimeve teknike të automjeteve për periudhën 2007-2008, periudhë kjo gjatë së cilës nuk ka qenë fare në fuqi vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. Reference MTPT/332/09 i datës 06.07.2009.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se në rastin konkret nuk është provuar me asnjë provë konkrete se paditësi ka pranuar ose ka krijuar të ardhura më të larta se ato të deklaruara andaj edhe rritja e qarkullimit nga e paditura për paditësin, mbi bazat e ngritjes së çmimit bazuar në çmimoren e

MTPT-së, e cila nuk ka qenë në fuqi gjatë periudhës së kontrollit 2007-2008, është e pa bazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore dhe faktike në dispozitat ligjore të aplikueshme të legjislacionit tatimor dhe në shkresat e lëndës.

Prandaj, gjykata duke vepruar sipas rekomandimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.251/2014 të datës 12.04.2018, në rivendosje ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr.436/2009 i datës 08.12.2009 të Administratës Tatimore të Kosovës, ka eliminuar të metat e konstatuar me aktgjykim dhe në kuptim të nenit 81.I paragraf 2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/-222, si dhe nenit 46 paragraf 1 dhe 2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Komerciale - dhoma e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur, në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të dhomës së shkallës së dytë, të Gjykatës Komerciale, ndër të tjera theksohet se: Pretendimet ankimore të paditurës nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Tutje theksohet se: Kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata Komerciale - dhoma e shkallës së dytë, duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë

ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe anulimin e vendimit të të paditurës, konstatoi se vendimi i saj është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimi të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, dhoma e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditurës, dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala e paditur në kërkesën e saj. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me aprovimin si të bazuar të kërkesë padisë së paditësit dhe anulimin e vendimit të të paditurës.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës - Departamenti i Ankesave, me nr.436/2009 të datës 08.12.2009, me të cilin është refuzuar ankesa e tatimpaguesit ASH "G.", me pronar: Xh.A. nga P., Rr: "S.", si e pa bazë kundër vendimit mbi Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të Administratës Tatimore – Regjioni P... II, me arsyetimin se tatimpaguesi ka nën dekluar shitjet dhe i njëjti nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e çmimit për kontrollim teknik nga MTPT, sepse çmimorja ka qenë unike dhe obligative për të gjitha qendrat e kontrollit teknik, nuk është vendim i drejtë dhe i ligjshëm, sepse nga provat e administruara nuk është provuar se tek paditësi nga kontrolli i kryer sipas raportit të kontrollit për periudhën kontestuese se janë hasur parregullsi në mbajtjen e regjistrimeve, faturave të shitjes kuponëve dhe të librave apo se janë bërë nën deklarime të qarkullimit, apo shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas nenit 376 të Ligjit nr.02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor përcaktohet se: *"Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm"*.

Sipas nenit 4 të Rregullores nr.2005/52 për Tatimin në të Ardhura Personale përcaktohet se: *"Të ardhurat e tatueshme për një periudhë të tatueshme do të thotë ndryshimi ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës së tatimit dhe zbritjet e lejueshme sipas kësaj rregulloreje lidhur me të ardhurat e tilla bruto"*.

Sipas nenit 17.2 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat përcaktohet se: *Vlerësimi i Drejtorit do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: a. librat, regjistrimet, kuponat, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit; b. librat, regjistrimet, kuponat, faturat, ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë; c. informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit; d. informata të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij.*

Në kuptim të dispozitave të lartë cekura gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se e paditura nuk ka vepruar drejtë kur ka aplikuar çmimoren e shërbimeve të kontrollës teknike për mjetet motorike, të përcaktuar sipas Vendimit me nr. ref. MTPT/332/09, të nxjerr nga Qeveria e

Republikës së Kosovës, me datë 06.07.2009, dhe e ka ngarkuar paditësin me qarkullim dhe tatim shtesë, duke i rritur çmimet e deklaruara për shërbimet e kontrollimeve teknike të automjeteve për periudhën 2007-2008, sepse ky vendim nuk ka qenë në fuqi në atë periudhë ndërsa i njëjti nuk ka fuqi retroaktive. Vendimi i njëjtë ka hyrë në fuqi me datë 20.07.2009 dhe është bazuar në Ligjin nr.02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, i cili ka hyrë në fuqi me shpalljen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me Rregulloren e UNMIK/REG/2007/33 të datës 12.12.2007. Nga shkresat e lëndës dhe faturat-urdhërpagesat shihet se disa klientë kanë paguar kontrollin teknik të automjetit në shumën prej 10-15€ e jo në shumën e pretenduar nga e paditura 25€. E paditura me asnjë provë konkrete nuk e ka provuar faktin se paditësi ka pranuar ose ka krijuar të ardhura më të larta se ato të deklaruara me fatura, andaj edhe rritja e qarkullimit nga e paditura për paditësin mbi bazën e vendimit të saj nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera se nuk janë marrë për bazë vlerësimet e ATK të cilat janë bazuar në evidencat deklarimet si dhe informatat e marra nga MTPT dhe dispozitave të ATK në fuqi se çmimorja ka qenë ka qenë unike dhe obligative etj., këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim ashtu si u theksua si më lartë janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta për deri sa të njëjtat me të drejtë janë refuzuar të pabazuara dhe jo të qëndrueshme duke u dhënë arsyetim ligjor si në arsyetim të aktgjykimeve të tyre të cekura si më lartë, andaj pretendimet në kërkesë nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje nga çka ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: “Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”.

Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, LATP-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe në këtë çështje nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1., të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.180/2024, më datë 24 Janar 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani